

VENDIM
Nr.333, datë 28.4.2010

PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Brendshme ruan dhe siguron, me punonjës të Policisë së Shtetit, selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore, në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndërtesat e gjykatave të të gjitha shkallëve, si dhe të Gjykatës Kushtetuese ruhen me punonjës të Policisë së Shtetit, për të siguruar rendin dhe qetësinë gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore.

3. Fondi i pagave dhe i shpenzimeve, i nevojshëm për zbatimin e pikave 1 e 2 të këtij vendimi, të mbulohet nga fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Brendshme.

4. Objektet që aktualisht janë në ruajtje nga Policia e Shtetit e që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe objektet e përcaktuara në pikën 2, jashtë orarit zyrtar dhe në ditët e pushimit, të merren në ruajtje nga vetë subjektet, duke filluar nga data 1.1.2011, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8770, datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, të ndryshuar.

5. Subjektet përkatëse, të përmendura në pikën 4 të këtij vendimi, të parashikojnë fondet buxhetore, për sigurimin e objekteve, gjatë hartimit të projektbuxhetit për vitin 2011.

6. Vendimi nr.589, datë 5.9.2007 i Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha